



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 233/2025
Datë: 03 prill 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 03 prill 2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Z. Anton Hasanaj, prokuror në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, avancohet në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Gjakovë nga data 15 prill 2025.
2. Obligohet z. Anton Hasanaj që të koordinohet me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë për përfundimin e lëndëve të cilat i ka në punë.
3. Z. Anton Hasanaj ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore.
4. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur më datë 03 prill 2025 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit KPK/KATPSH të datës 24 mars 2025, ku pas shqyrtimit të të njëjtit raport, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Anton Hasanaj;
- Kryeprokurorit të PTH Gjakovë;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.